

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Numri i lëndës: **Pml. Kzz 98/2016 (HT) Gjykata Supreme
PN 162/16 Gjykata e Apelit)
P. nr. 58/2014 Gjykata Themelore e Mitrovicës**

Date: **10 maj 2016**

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Jorge Martins Ribeiro, (kryetar i kolegjit dhe gjyqtar referues), dhe gjyqtari i EULEX-it Krassimir Mazgalov dhe gjyqtarja e Gjykatës Supreme Valdete Daka si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore e EULEX-it Kerry Moyes si procesmbajtëse, në lëndën penale P. nr. 58/2014 para Gjykatës Themelore të Mitrovicës, në lidhje me të pandehurin:

HT,

I pandehuri është dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. nr. 58/2014, më 27 maj 2015, me shtatë (7) vjet burgim si dënim unik për pika të shumëfishta të veprës penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile, në përputhje me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ-së), në pritje të shqyrtimit të apelit nga Gjykata e Apelit.

Duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 31 mars 2016 nga avokati mbrojtës Artan Qerkini (Sejdiu & Qerkini, SH.P.K) në emër të të pandehurit **HT**, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN 162/16(9) të datës 9 mars 2016;

Pas shqyrtimit të përgjigjes së Prokurorit të Shtetit të paraqitur më 12 prill 2016;

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 10 maj 2016;

Në përputhje me nenin 418 dhe nenet 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (KPK) me shumicë votash¹

lëshon këtë:

¹ Me shumicë votash është konstatuar se kërkesa është e pranueshme. Kërkesa refuzohet njëzëri si e pabazuar.

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur më 31 mars 2016 nga avokati mbrojtës Artan Qerkini (Sejdiu & Qerkini, SH.P.K) në emër të të pandehurit HT, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN 162/16(9) të datës 9 mars 2016, është e pranueshme por refuzohet si e pabazuar, në përputhje me nenin 437 të KPP-së.

ARSYETIMI

1. Historia e Procedurës

1.1 Paraburgimi ndaj të pandehurit **HT** është urdhëruar që prej datës 27 maj 2015, pasi në këtë ditë Gjykata Themelore e Mitrovicës e shpalli atë fajtor për pika të shumëfishta të krimeve të luftës dhe e dënoi me shtatë (7) vjet burgim.

1.2 I pandehuri është urdhëruar të dërgohet në paraburgim në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë derisa aktgjykimi të merr formën e prerë.

1.3 Më 23 shtator 2015 Gjykata Themelore e Mitrovicës dha leje për hospitalizimin e të pandehurit në Klinikën për Sëmundje Infektive në QKUK për shkak të një “problemi akut me mëlçinë” sipas raportit mjekësor të Qendrës së Paraburgimit në Dubravë, e më vonë të konfirmuar me raportin mjekësorë të lëshuar nga QKUK më 29 shtator 2015.

1.4 Pas incidentit të datës 7 dhjetor 2015 (kur i pandehuri është gjetur se është lëshuar pa asnjë përcjellje dhe më vonë është kthyer vetë në dhomën e tij në Klinikën për Sëmundje Infektive²), më 16 dhjetor 2015 mjeku ndërkombëtar ka kryer kontrollimin mjekësor të të pandehurit dhe ka bërë raportin më 31 janar 2016, duke deklaruar (në mesin e detajeve të tjera) siç vijon: “*gjendja shëndetësore e HT duhet të konsiderohet si e mirë dhe e qëndrueshme (...). HT mund të qëndrojë në burg. Duhet të ushqehet me shumë proteina. Ekzaminimi laboratorik duhet të bëhet kohë pas kohe dhe duhet t’i mundësohet kontrollimi nga mjeku i përgjithshëm dhe infektologu (...). Qëndrimi i HT në burg në gjendjen e tanishëm mjekësorë nuk paraqet rrezik për jetën e tij*”.

1.5 Prandaj, më 18 shkurt 2016 kryetari i trupit gjykues i Gjykatës Themelore të Mitrovicës urdhëroi transferimin e menjëhershëm të tij nga QKUK-ja për në Burgun e Sigurisë së Lartë

² “Përafërsisht rreth orës 17:00 stafi korrektues nën monitorimin e Ekipit Monitorues të EULEX-it kanë shkuar në Klinikën për Sëmundje Infektive në QKUK për të kontrolluar të burgosurin **HT**. Kur arritën në dhomë gjetën vetëm policin **FP** i cili deklaroi se i burgosuri kishte shkuar i përcjellë nga polici **FQ** për një kontrolle në Klinikën e Dermatologjisë. Më njoftuan dhe u kam sugjeruar të presim pak derisa të kthehet i burgosuri dhe polici i përmendur. Rreth orës 17:35 më njoftuan prapë se polici ishte kthyer por i burgosuri jo. Pastaj, pas konsultimit me ushtruesin e detyrës së drejtorit të përgjithshëm **SK** j u nisa për të shkuar te vendi bashkë me **IK-Shefin** e Operativës. Pasi i burgosuri nuk ishte në dhomën e tij, dhe të dy policët që duhej ta ruanin ish-in në dhomë, pas konsultimit me ushtruesin e detyrës së drejtorit të përgjithshëm, e njoftova Policinë e Kosovës. Arrita në Klinikën për Sëmundje bashkë me **IK** rreth orës 18:00, kurse rreth orës 18:10 u kthye edhe i burgosuri në dhomë” – këmbimi i e-maileve nga zyrtarët e RKS Data: dhjetor 8, 2015 ora 08:58:15 GMT+1

në Podujevë, duke marrë parasysh faktin se ekziston “*rreziku që i pandehuri mund të vazhdojë t’i keqpërdorë kushtet e paraburgimit (...) se standardet e sigurisë në Qendrën e paraburgimit në Dubravë mund të jenë shkelur nga stafi i atjeshëm. Prandaj është e domosdoshëm që ai të vendoset në Burgun e Sigurisë së Lartë në Podujevë (...)*”.

1.6 Avokati mbrojtës i të pandehurit ka paraqitur ankesë kundër këtij urdhri të fundit, i cili është refuzuar si i pabazuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të datës 9 mars 2016.

1.7 Më 31 mars 2016 avokati mbrojtës ka paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit.

1.8 Prokurori i Shtetit ka paraqitur përgjigjen më 12 prill 2016.

2. Parashtrësit e palëve

2.1. Avokati mbrojtës në emër të të pandehurit HT:

Avokati mbrojtës pohon se aktvendimi i Gjykatës së Apelit është i bazuar në shumë shkelje të KPP-së, përkatësisht të nenit 202, dhe të Ligjit për ekzekutimin e Sankcioneve Penale, përkatësisht të nenit 93 (për transferimin e peronave të dënuar) dhe të nenit 107 (për procedurën disiplinore). Thelbi i argumentit është se kryetari i trupit gjykues i cili ka urdhëruar paraburgimin nuk ka fuqinë ligjore për transferimin e të paraburgosurit nga njëra qendër në qendrën tjetër të paraburgimit, pasi vetëm drejtori i përgjithshëm i shërbimit korrektues ka të drejtë ta bëjë këtë si pasojë e procedurës disiplinore, në përputhje me nenin 201 të KPP-së (mbi disiplinën e të paraburgosurit) në lidhje me dispozitat e tjera të përmendura.

2.2. Përgjigja e prokurorit të shtetit:

Prokurori i shtetit propozon që kërkesa të hedhet poshtë si e papranueshme pasi që nuk bie në asnjërin situatë të përcaktuar me nenin 432 të KPP-së. Në rastin e par. 1 për shkak se procedura është ende në vazhdim e sipër në kuptim që ankesat mbi dënimin akoma duhet të vendosen, dhe në rastin e par. 4 për shkak se paraqitësi i ankesën kundërshton transferimin e të paraburgosurit, situatë kjo që nuk është paraparë me këtë paragraf, pasi që përmban vetëm rastet e vendimeve mbi caktimin apo vazhdimin e paraburgimit.

3. Gjetjet e kolegjit

A) Mbi pranueshmërinë *stricto sensu*

3.1 Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nga avokati mbrojtës dhe përgjigja nga prokurori i shtetit janë paraqitur me kohë dhe brenda afatit, sipas nenit 418 par. 3 të KPP-së dhe nenit 435, par. 2 *in fine*.

3.2 Përkundër faktit se nuk ka asnjë deklaratë se i pandehuri pajtohet me kërkesën e cila është nën shqyrtim, sipas neneve 418 (4) dhe 376 (1.8) të KPP-së, duke pasur parasysh formulimin

eksplicit dhe të saktë të nenit 433 (“Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqet nga (...) i pandehuri ose avokati i tij mbrojtës”), Gjykata sipas detyrës zyrtare ka vendosur mos ta hedhë poshtë kërkesën për këtë arsye specifike.

3.3 Në pajtim me nenin 436, par. 1 të KPP-së, “Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon”. Kjo, natyrisht nuk është pengesë për të analizuar dispozitat e tjera që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara.

3.4 Gjykata, me shumicë votash³, nuk e ndan plotësisht mendimin e prokurorit të shtetit mbi pranueshmërinë e kësaj kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë (tani e tutje KML). Nëse në njërin anë është e vërtetë se par. 1 i nenit 432 të KPP-së nuk është i zbatueshëm si bazë për ta arsyetuar këtë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, pasi që i pandehuri ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit me të cilin është shpallur fajtor (P. Nr. 58/2014, më 27 maj 2015), në anën tjetër është gjithashtu e vërtetë se nëse formulimi i fjalëpërfjalshëm i par. 4 thotë “vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit” fushëveprimi i urdhrin mbi transferimin e një të paraburgosuri bie nën nivelin e njëjtë të mbrojtjes së nevojshme të të drejtave dhel lirive themelore të një individi, pasi që në fakt të dy llojet e vendimeve (caktimi ose vazhdimi dhe transferimi) mund të shtrojnë pyetje të barasvlershme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore - përveç kësaj, neni 3, par. 2 i KPP-së përcakton se "(...) Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

3.5 Konstatimi i mëparshëm dhe referimi i tij në të drejtat themelore është në lidhje me dispozitën e përcaktuar në nenin 433 par. 4 të KPP-së, sipas të cilit nëse vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstaton se vendimi gjyqësor i formës së prerë kundër të pandehurit ka shkelur të drejtat e njeriut, atëherë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë do të jetë e mundur kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Shumica e kolegjit në këtë pikë thekson dy ide kyçe: një njërin anë, mbrojtjen e të drejtave themelore (siç është cekur më lartë) ose të drejtave të njeriut (siç është formuluar në nenin 433, par. 4 të KPP-së) nuk duhet t'i nënshtrohen një interpretimi të kufizuar doktrinar të ligjit, në anën tjetër, nëse ligjvënësi ka paraparë një mundësi të tillë kundër vendimit të Gjykatës Supreme atëherë, *a fortiori*, patjetër duhet kuptuar se ajo gjithashtu është e mundur edhe kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit⁴.

3.6 Prandaj, ky kolegji me shumicë ka vendosur se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme.

B) Mbi meritat

3.7 Siç është vërejtur më lart, vendimi mbi transferimin e të paraburgosurit, nga natyra e tij, mund të shtrojë disa pyetje apo çështje të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit, me fjalë të tjera, disa pyetje apo çështje të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive

³ Sipas gjyqtareve vendore anëtare e kolegjit, vetëm vendimet mbi caktimin ose vazhdimin e paraburgimit, sipas nenit 432, paragrafit 4 të KPP-së mund t'i nënshtrohen kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

⁴ Natyrisht, edhe nëse nuk rrjedh nga vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

themelore të të paraburgosurit; ky pohim është, sipas mendimit të gjykatës, i dukshëm, i qartë, por le ta marrim vetëm një shembull: le ta paramendojmë një rast të transferimit të në të paraburgosuri në një shtet të madh⁵ i cili *de facto* shpie në mungesë të vizitave, jo si dënim i ligjshëm.

3.8 Gjykata nuk mund të pajtohet se dispozitat e përmendura nga avokati mbrojtës mund të interpretohen në atë mënyrë që do të ishte e kundërligjshme për gjyqtarin që të urdhërojë transferimin pasi që vetëm drejtori i përgjithshëm është i autorizuar që ta bëjë një gjë të tillë. Në fakt, dispozita e nenit 93 e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale jo vetëm që i referohet personave të shpallur fajtor (jo rastit të të paraburgosurit në qendër të paraburgimit—dhe analogjia në dëm të të pandehurit është e ndaluar, sipas nenit 2, par. 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), *mutatis mutandis*), por gjithashtu nuk ndalon (dhe nuk do të mundte ...) intervenimin e drejtpërdrejt të gjyqtarit.

3.9 Në këtë pikë duhet bërë dy referenca. E para është neni 5, par. 2 i KPP-së, “Gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë”, dhe çështjet të cilat dalin nga ekzekutimi i paraburgimit nuk përjashtohen nga fushëveprimi i kësaj norme, kjo do të thotë se në fund të fundit është çështje e gjykatës që të parandalojë çdo keqpërdorim të të drejtave të pandehurit. E dyta është se nga pikëpamja logjike dhe doktrinare, e cila është e lidhur me referencën e parë, dhe në përputhje me Ligjin Superior të Kosovës, që do të thotë Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), në pajtim me nenet 22, par. 1, 23, 29, par. 1 dhe 4 dhe neni 102, par. 1 deri në 3 të Kushtetutës, është e qartë të konstatohet se gjyqtari është gardiani i fundit i të drejtave dhe lirive themelore të qytetarit, e jo drejtori i përgjithshëm i shërbimit korrektues.

3.10 Përfundimisht, neni 107 i Ligjit për ekzekutimin 3e sanksioneve penale i referohet procedurës disiplinore. Sidoqoftë, përsëri duhen bërë dy vërejtje: jo vetëm që nuk ka është zhvilluar procedura disiplinore si pasojë e incidentit më 7 dhjetor 2015, por gjithashtu, edhe po të zhvillohej procedura disiplinore, i paraburgosuri nuk do të duhej t’i nënshtrohej asaj pasi që ai nuk është përgjegjës për zbatimin e detyrave të stafit.

Në bazë të asaj që u tha më lart, është vendosur si në dispozitiv.

⁵ Për shembull, mund të përmendim rastin e Australisë, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara, për mos ta përendur Federatën e Rusisë, por e njëjta vlen edhe në shtetet më të vogla pasi të mjetet e të afërme të të pandehurit për të udhëtuar mund të jenë të pamjaftueshme, që në praktikë shpie në privim të kundërligjshëm dhe të qëllimshëm të së drejtës për të pasur vizita.

Kryetar i kolegjit

Jorge Martins Ribeiro

Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtëse

Kerry Moyes

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Anëtarët e kolegjit

Krassimir Mazgalov

Gjyqtar i EULEX-it

Valdete Daka

Gjyqtare e Gjykatës Supreme